

Informacion i Pergjithshem per Paktin e Stabilitetit per Europen Juglindore dhe Rrjetin e Shendetesise se Europes Juglindore

Pakti i Stabilitetit per Europen Juglindore i ka fillimet ne vitin 1999, pas mbarimit te konfliktit ne Kosove, dhe eshte nje perpjekje e qeverive te vendeve anetare te BE per te stabilizuar rajonin e Europes Juglindore, pas luftrave, duke punuar se bashku me vendet e rajonit dhe me organizatat nderkombetare ne fushat e Demokracise, Ekonomise, dhe Mbrojtjes dhe Sigurimit (<http://www.stabilitypact.org>).

Aktivitetet ne sektorin e Shendetesise, kryen nen supervizimin e Rrjetit te Shendetesise se Europes Juglindore, qe perbehet nga perfaqesues te larte te Ministrive te Shendetesise ne rajon, ne bashkepunim me organizatat partnere si Organizata Boterore e Shendetesise, Keshilli i Europes, dhe Banka per Zhvillim e Keshillit te Europes (<http://euro.who.int/stabilitypact>).

Rrjeti i Shendetesise se Europes Juglindore i ka fillimet ne nenshkrimin e Deklarates se Dubrovnikut ne vitin 2001, ku eshte rene dakort qe vendet e rajonit: Shqiperia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonise, Moldavia, Rumania, Serbi dhe Mali i Zi, te punonin se bashku, duke zbatuar 8 projekte te perbashketa ne ceshtje prioritare te shendetit publik si shendeti mendor, nutricioni, sherbimet e urgjences, gjaku dhe nenproduktet e tij, semundjet infektive, sistemet e informacionit, duhani, dhe me vone ne vitin 2005 dhe shendeti i nenes dhe femijes.

Rrjeti i Shendetesise se Europes Juglindore synon forcimin e bashkepunimit rajonal, kalimin e pronesise se ketij bashkepunimi nga Europa ne rajon, duke ndihmuar vendet qe te pershtasin ose permiresojne strategjite dhe legjislacionin e tyre lidhur me prioritetet shendetesore me ato te BE; duke zbatuar projekte me rendesi rajonale dhe duke rritur kapacitetet lokale te punonjesve te shendetesise per tu pergjigjur ne menyre te duhur sfidave te shendetit publik; duke bere te mundur keshtu, afrimin e vendeve te rajonit dhe Shqiperise me afer integrimin ne familjen e perbashket Europiane.

Projektet jane ne faza te ndryshme zhvillimi, Shqiperia eshte vendi ku eshte dhe zyra rajonale per projektin e semundjeve infektive.

Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Shendetesise, rikonfirmojne qendrimin e tyre per zbatimin sipas standarteve te percaktuara te projekteve te miratuara, qendrim i shprehur dhe ne Forumin e Dyte te Ministrave te Shendetesise se rajonit, te mbajtur Nentorin e kaluar ne Shkup; si dhe vullnetin e mire per te forcuar bashkepunim rajonal dhe transferimin e pronesise se ketij bashkepunimi ne rajon. Per kete qellim, MSH ka hapur nje zyre mbeshtetese per Sekretariatin e Rrjetit te Shendetesise te Europes Juglindore, prane kesaj Ministrie, si hap i pare ne drejtim te transferimit te bashkepunimit ne rajon.

Rreth 5 milion Euro jane dhuruar nga vendet donatore qe nga 2001 per zbatimin e 7 projekteve ne 7 vende te rajonit. Rendesia e projekteve qendron jo aq shume ne sasine e parave te perdorura se sa ne arritjen e nje klime te mire bashkepunimi qe do coje te gjithë rajonin me afer integrimin ne BE.